



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net



PSH. nr. 884/21

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, **Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Kimete Gashi**, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Komuna Gjakovë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), (Nr.Protokolli 884/22), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik (OE) “ALBI Company” SH.P.K - Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kompleksit të tenisit në Komunën e Gjakovës”, me numër të prok: 632-17-026-5-1-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me 07 Nëntor 2022, mori:

V E N D I M

Refuzohet, si e pa bazuar kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Gjakovë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “ALBI Company” SH.P.K - Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i kompleksit të tenisit në Komunën e Gjakovës”, me numër të prok: 632-17-026-5-1-1.

A r s y e t i m

Me datën 14.12.2021, Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal Gjakovë, ka dorëzuar në OSHP kërkesën për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP-së, ndaj OE: “ALBI Company” SH.P.K - Rahovec.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar me 14.12.2021 nga Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues kërkesën për diskualifikim të OE “ALBI Company” SH.P.K. - Rahovec, me numër të prokurimit 632-17-026-5-1-1 dhe i njëjti të përfshihet në listën e zezë, me arsyet si me poshtë.

OE "ALBI Company" SH.P.K. në Rahovec, për aktivitetin e prokurimit me numër 632-17-026-5-1-1, nuk ka bërë realizimin e punëve konform kushteve të kontratës dhe nuk iu është përgjigjur urdhëresave për fillim të punimeve dhe shkresave elektronike (e-mailave) të Menaxherit të kontratës, i cili ka ushtruar përgjegjësitë e tij në emër dhe për llogari të AK. Për keto arsye, AK (me shënime si më sipër) me datën 10.12.2021, e ka ndërprerë kontratën për realizimin e projektit "Ndërtimi i kompleksit të tenisit në Komunën e Gjakovës" duke e inicuar njëherësh dhe procedurën për diskualifikim të OE "ALBI Company" SH.P.K. – Rahovec.

Me datën 14.12.2021, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka njoftuar OE "ALBI Company" SH.P.K. - Rahovec, lidhur me kërkesën e cituar si më sipër të AK dhe i njëjti ka kthyer përgjigje se nuk pajtohet me kërkesën e AK pasi që dispozitat e nenit 99.2 të LPP-së janë të qarta dhe aplikohen ndaj Operatorëve Ekonomik të cilët paraqesin të dhëna të rreme apo ndonjë dokument të falsifikuar, dhe jo ndaj Operatorëve Ekonomik të cilëve iu shkëputet kontrata, njëanshëm, qëllimisht dhe pa baza ligjore.

Paneli Shqyrtues mori në shikim të gjitha shkresat e kësaj lënde të cilat i analizoi në kontekstin e veprimeve të ndërmara nga të dyja palët, nga kuadri aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër dhe konstatoi se, kërkesa e AK në rastin konkret, në kuptim të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nuk përfshihet nën kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit sepse, prej momenti të nënshkrimit të kontratës të gjitha të drejtat dhe autorizime tlidhur me zbatimin e një kontrate të tillë, kalojnë nën kompetencat e plota të Autoritetit Kontraktues së paku për arsyet si në vijim:

- Në kuptim të nenit 99 të Ligjit të cituar parashifet qartë se kompetencat e OSHP, nga cilësia e tij si organ në shkallë të dytë përfshijnë në tërësi procesin e prokurimit dhe shprehimisht theksohet se, cituar "OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë Pjesë".
- Kurse, në kuptim të nenit 31, të Ligjit të cituar (Ekzekutimi i kontratave) parashihet se, cituar: "Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet..." pa nevojë që të citohen paragrafët tjerë të dispozitës së cituar.

Prandaj bazuar në të lartëcekutrat Paneli konsideron se realizimi i një kontrate, bije nën kujdesin e AK, përfshirë ndërmarrjen e çdo mase të nevojshme sipas vlerësimit të pavarur të tij, duke i kujtuar se, përveç tjerash mund të vihen në zbatim, natyrisht në varësi të rrethanave dhe natyrës së çështjes, po ashtu dhe dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, i cili parasheh dhe rregullon në mënyrë të detajuar raportet kontraktuese dhe/ose permbushjen ose jo të detyrimeve të cilat burojnë nga raportet me natyrë të tillë.

Prandaj kërkesa e AK për diskualifikim dhe përfshirje të OE në listën e zezë, sipas fakteve dhe rrethanave të krijuara në këtë rast, nuk përfshihet nën jurisdiksionin e LPP. Paneli shqyrtues është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK ka ofruar prova ashtu siç potencohet në paragrafin 2, të nenit 99 të këtij Ligji, sipas të cilit, cituar: “Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare”.

Paneli konsideron se AK nuk ka ofruar në këtë rast ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE ALBI Company” SH.P.K. - Rahovec, mirëpo përpos tjerave, theksuar si më sipër Paneli konsideron se për shkak të mos nënshkrimit të kontratës AK ka të drejtë të bëjë konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, kurse në varësi të shkeljeve ka po ashtu të drejtë ti drejtohet autoriteteve gjyqësore.

Paneli shqyrtues, duke ju referuar të lartëcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 99.2 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal Gjakovë;
- 1x1 OE – “Albi Company” SH.P.K - Rahovec;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.